**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

**OSHP: 2026/0605**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) ARITECH, kundër Vendimin për dhënie të një kontratë të KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me paisje te teknologjis informative me numër të prokurimit 622-26-5095-5-5-8, me 28/09/2026, mori:

## Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE ARITECH me nr. 2026/0605, e datës 17/08/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me paisje te teknologjis informative me numër të prokurimit 622-26-5095-5-5-8.

2. **Anulohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, ndërkaq aktiviteti i prokurimit Furnizim me paisje te teknologjis informative me numër të prokurimit 622-26-5095-5-5-8 kthehet në **Rivlerësim**.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik ARITECH.

## Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 25.06.2026 KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Ftesen për ofertim, për aktivitetin e Prokurimit me titull Furnizim me paisje te teknologjis informative me numër të prokurimit 622-26-5095-5-5-8.

Me 30.07.2026 KOMUNA E PEJES duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është rekomanduar për kontratë OE INFINITT SH.P.K.

Me 04.08.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 05.08.2026 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 17.08.2026, OE ARITECH, ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0605, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhenie te kontrates.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues ARITECH, janë parashtruar si në vijim:

AK/Komisioni vlersues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Udhëzimin operativ e rregulloren për prokurim publik.

AK/zyra e prokurimit me 30.07.2026 ka nxjere njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ka rekomanduar per kontrate OE INFINITT SH.P.K.

Me 30.07.2026 kemi derguar kerkese per qasje ne dokumente zyrtare dhe me 31.07.2026 AK na ka ofruar qasjen ne dokumentet e tenderit per projektin ne fjale.

Nga dokumentet te cilat kemi pranuar ne qasjen ne dokumente zyrtare konstatojme se AK ka rekomanduar per kontrate OE te papergjegjshem.

Konform nenit 6.2 te kontrates se AQP-se nr. UA/2016-23-6106-1-1-1/C403 deri C420 OE mund te aplikojne vetem me paisjet- brendin per te cilin kane dorezuar autorizim dhe jane kualifikuar ne AQP.

OE INFINITT SHPK eshte i kualifikuar me brendin HP ndersa per kete aktivitet te prokurimit fare nuk ka dorezuar specifikimin teknik dhe katalogun e produkteve te ofertuara.

Ne mareveshjen publike kornize (baze per kete ftese per ofertim) shprehimisht kerkohet qe: per secilin produkt duhet te specifikohe emri i modelit qe ofertoni. Ne kolonen e pare te secilit produkt tek Prodhuesi- Brand name duhet te shkruani emrin e modelit duke perfshire emrin e prodhuesit dhe emrin e sakte te modelit qe ofertoni

Sipas Udhezuesit nr. 001/2023 per Prokurim publik pika 10- Sqarimi i tendereve gjate procesit te vleresimit te tendereve – Nese mungon specifikacioni teknik per mallrat e ofruara dhe katalogu (specifikimi teknik- AK percakton kerkesat minimale dhe maksimale te nje produkti, ndersa OE duhet te dorezoj specifikimin e detajuar te mallrave te ofruara. Perveq ne raste kur OE nuk mund te dorezoj specifikimin teknik te nje produkti te caktuar p.sh peme/perime etj. OE dorezon deklaraten ku deklaron se mallrat do te jene ne perputhje me specifikimin e kerkuar atehere AK duhet te veproje konform udhezimit dhe rregullores per prokurim publik duke refuzuar tenderin pa kerkuar informacion te metutjeshem, bazuar ne nenin 28 te LPP-se.

Ne baze te specifikimeve teknike te hartuara per pozicionin 4 eshte kerkuar Skaner Canon, OE ne fjale nuk eshte i kualifikuar ne AQP per te ofertuar produkte te brendit Canon per vetem HP, AK para se te rekomandoj per kontrate eshte dashur te kerkoje sqarime shtese broshurat e produkteve pasiqe eshte dyshuese se projekti do te realizohet ne teresi sipas specifikimeve teknike te parashtruara ne ANEKS 1 te FPO-se.

Per raste te ngjashme jane leshuar vendime te OSHP-se ne te kaluaran, si prove cekim vendimin nr. 214/22 AK eshte dashur te trajtoje oferten e OE INFINITT SHPK si jo-normalisht te ulet pasiqe bazuar ne cmimin total te dhene nga OE dhe kerkesat e parashtruara ne kemi dyshime se mund te realizohet projekti sipas specifikimeve teknike ne kerkese pasiqe vlera e produkteve-kosto eshte reth 20% me e larte se buxheti i planifikuar per kete projekt rjedhimisht jemi detyruar te kerkojme qasje si pale me interes ne kete projekt.

Konform nenit 61 te LPP-se dhe nenit 41 te rregullores per prokurim publik AK eshte dashur te trajtoje oferten e OE ne fjale si jonormalisht te ulet siq parashihet ne dispozitat ligjore ne fuqi kur tenderet ne shikim te pare duken jo te besueshem nese krahasohet me objektin e kontrates.

AK/zyra e prokurimit eshte dashur qe konform nenit 61.2 te LPP-se te trajtoje oferten e OE INFINITT SH.P.K. dhe te zhvilloje proceduren inter partes per te kerkuar deshmi konform dispozitave ligjore:

2.1 ekonominë e procesit të prodhimtarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;

2.2 çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur; 2.3 çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose

2.4 origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

Sipas LPP-se dhe Rrpp ky OE eshte dashur te eleminohet nga procedura e prokurimit, per shkak se nuk eshte i pergjegjshem ne aspektin administrativ.

Mare parasysh faktet e lartecekura konstatojme se AK/komisioni vleresues ka rekomanduar per kontrate OE te papergjegjshem i cili ne baze te ofertes se dorezuar nuk ploteson specifikimet teknike per PC dhe ka ofruar produkte nga prodhues per te cilet nuk eshte kualifikuar ne ofertim ne AQP.

Demet materiale ;

Si pasojë e shkeljeve të lartëcekura nga AK/ komisioni vlereses ka ardhe deri te dhenia e kontrates per OE te papergjegjshem, ne kete menyre nuk jane respektuar dispozitat ligjore te lartecekura dhe kompanise sone i eshte mohuar fitimi i nje kontrate publike si dhe fitimi simbolik i paramenduar nga kjo kontrate.

Kerkojme nga Organi shqyrtues i prokurimit qe pas shoshitjes se provave dhe fakteve te aprovoje ankesen e kompanise sone si te bazuar dhe lenda te kthehet ne rivleresim

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Operatori Ekonomik Aritech SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim duke kundërshtuar vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe duke pretenduar se operatori ekonomik i rekomanduar nuk i përmbush specifikimet teknike dhe kushtet e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit. Pas shqyrtimit të pretendimeve dhe dokumentacionit të procedurës së prokurimit, Autoriteti Kontraktues konstaton se kërkesa është e pabazuar.

Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit të ofertave ka vepruar në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, Dosjen e Tenderit dhe specifikimet teknike, duke vlerësuar ofertat vetëm mbi bazën e dokumenteve të dorëzuara dhe kritereve të përcaktuara paraprakisht. Pretendimet e parashtruesit nuk mbështeten me prova që dëshmojnë ndonjë shkelje të dispozitave të LPP-së, por paraqesin vetëm supozime lidhur me ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar.

Lidhur me pretendimet për markën, katalogët dhe specifikimet teknike, Autoriteti Kontraktues vlerëson se Komisioni Vlerësues ka kryer vlerësimin konform kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe nuk ka konstatuar mospërputhje që do të përbënte bazë ligjore për eliminim. Për rrjedhojë, këto pretendime refuzohen si të pabazuara.

Po ashtu, nga shqyrtimi i ofertës së vetë parashtruesit rezulton se oferta financiare e tij është më e lartë se vlera e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit, gjë që e bën ofertën të papërgjegjshme sipas dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik. Për këtë arsye, pretendimet e ngritura nuk mund të ndikojnë në ndryshimin e vendimit të Autoritetit Kontraktues.

Duke u mbështetur në këto fakte, Autoriteti Kontraktues vlerëson se procedura e vlerësimit është zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kërkesa për rishqyrtim refuzohet si e pabazuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 21.08.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0605, ndërsa me datë 03.09.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0605, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesrisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës - mintender dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr

parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OEARITECH,eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0605 ka vlerësuar si në vijim:

PRETENDIMI 1

Pretendimi 1 i OE ankues është se AK/Komisioni i Vlerësimit, gjatë vlerësimit të ofertave, ka rekomanduar për kontratë OE INFINITT SH.P.K., ndonëse ky OE nuk i ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe në Marrëveshjen Publike Kornizë të AQP-pasi qe OE INFINITT SH.P.K. është i kualifikuar në AQP për brendin HP, ndërsa për aktivitetin konkret nuk ka dorëzuar specifikacionin teknik dhe katalogun e produkteve të ofruara. Sipas kushteve të AQP-së, OE mund të ofertojnë vetëm me brendet për të cilat janë autorizuar dhe kualifikuar.

Për më tepër, në pozicionin 4 të specifikimit teknik është kërkuar Skaner Canon, ndërsa OE i rekomanduar nuk është i kualifikuar në AQP për brendin Canon.

PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMIT 1

Lidhur me këtë pretendim, Ekspertja Shqyrtuese i është drejtuar zyrtarisht AQP-së për verifikim të kualifikimit të OE “INFINITT SH.P.K.” dhe përputhshmërisë së produktit të ofertuar me Marrëveshjen Publike Kornizë.

Nga përgjigjja zyrtare e AQP-së rezulton se OE “INFINITT SH.P.K.” është i kualifikuar për brendin HP dhe nuk mund të ofertojë me brende për të cilat nuk është i autorizuar. Po ashtu, AQP ka konfirmuar se skanerët nuk janë pjesë e Marrëveshjes Kornizë, ndërsa Pozicioni 4 tek specifikacioni I AK-se eshte  Skaner Canon, shih përgjigjen nga AQP:

Shih përgjigje sqarim shtese rreth pozicionit 4 nga AQP

Rrjedhimisht, bazuar në sqarimin zyrtar të AQP-së, konstatohet se OE “INFINITT SH.P.K.” nuk ka dëshmuar përputhshmërinë e Pozicionit 4 me kushtet e Marrëveshjes Kornizë, përkatësisht nuk ka qenë i autorizuar/kualifikuar për brendin Canon.

Për këtë arsye, pretendimi i OE ankues vlerësohet i bazuar.

PRETENDIMI 2

Lidhur me pretendimin e OE ankues për çmim anormalisht të ulët, Ekspertja Shqyrtuese sqaron se OE ankues pretendon se oferta e OE “INFINITT SH.P.K.” është anormalisht e ulët dhe se AK është dashur të kërkojë arsyetim sipas nenit 61 të LPP-së. Megjithatë, Eskperti shqyrtues sqaron se OE ankues nuk ka paraqitur argumente, kalkulime apo dëshmi konkrete që do të dëshmonin se oferta është anormalisht e ulët dhe se ekziston rrezik për realizimin e kontratës pasi qe sipas tij, kosto e pasijeve eshte reth 20% me e larte se buxheti i planifikuar

Vetëm krahasimi me buxhetin e planifikuar nuk është i mjaftueshëm për të konstatuar çmim anormalisht të ulët, për me teper duke u bazuar në përgjigjen e Autorittetit kontraktues (Vendim per rishqyrtim) dhene OE ankues "ARITECH" Sh.p k, ceket qarte se oferta e OE ankues është me çmim mbi vlerën e parashikuar sipas AK-së.

Rrjedhimisht, pretendimi për çmim anormalisht të ulët është i pabazuar, pasi nuk është mbështetur me dëshmi dhe argumente konkrete.

PRETENDIMI 3 – Mospërmbushja e specifikimeve teknike

OE ankues pretendon se OE "INFINITT SH.P.K." nuk i ka përmbushur specifikimet teknike të kërkuara dhe i referohet edhe Vendimit nr. 214/22 të OSHP-së.

PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMIT 3

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se OE "INFINITT SH.P.K." ka dorëzuar deklaratë për përmbushjen e specifikimeve teknike.

Në ftesën për ofertë ishte:

Ndersa sa i përket vendimit të referuar nga OE ankues,Ekspertja Shqyrtuese nuk ka pasur mundësi ta shqyrtojë atë në kuadër të këtij vlerësimi pasi qe me këtë nr. nuk ka gjetur ndonje të dhënë në ankesat e dorëzuara pran OShP-se dhe OE anukes nuk e ka bashkangjitur vendimin kesaj ankese.

Megjithatë, në rastin konkret çështja lidhur me përputhshmërinë e produktit dhe brendit të ofertuar është e qartë, veçanërisht duke marrë parasysh sqarimin zyrtar të AQP-së, sipas të cilit OE është i kualifikuar për brendin HP dhe nuk mund të ofertojë me brende për të cilat nuk është i autorizuar.

Pretendimi ankimor është pjeserisht I bazur.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me paisje te teknologjis informative me numër të prokurimit 622-26-5095-5-5-8.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtresat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka vendosur tja fal besimin e plotë konstatimit të ekspertit shqyrtues dhe rekomandimit të tij/saj se ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Në ketë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhenie të kontrates dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nënpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtresat dhe provat e ankuesit, si dhe raportin e ekspertit shqyrtues, dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështjeje, ka krijuar bindjen e pavarur të tij/saj se ankesa e OE ankues duhet të aprovohet pjesërisht si e bazuar.

Në këtë rast, Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i trajtuar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitat e neneve 113 dhe 114 të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.




Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Vedat Poterqoi**

**Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- OE - **ARITECH**
- Arkivës së OSHP-së: